

**VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHËSHME TË SHOQËRISË  
UJESJELLES KANALIZIME HAS SH.A**

**NR. 100 DATË 23/05 /2023**

Sot, më datë 23 Maj 2023, Ujesjelles Kanalizime Has sh.a, një shoqëri e themeluar sipas ligjit shqiptar, me kodin unik NIPT J66702907H, mbajti mbledhjen e Asamblesë. Mbledhja u thirr nga administratori i shoqërisë zoti Ferit Mazrreku, për të diskutuar mbi rendin e ditës si vijon:

**Çështjet e rendit të ditës:**

- Prishja e shoqërisë dhe shpallja e saj në likuidim.
- Emërimi i Likuidatorit.

**Në shqyrtim të rendit të ditës, Asambleja vëren:**

Shoqëria Ujesjelles Kanalizime Has sh.a nuk zhvillon më aktivitete pasi në përputhje me VKM Nr. 302, datë 11.05.2022 si dhe me marrëveshjen noteriale Nr. 1541 Rep. dhe Nr. 688Kol, datë 07.11.2022 midis Shoqërisë Ujesjelles Kanalizime Has sh.a dhe Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Kukës sha, kjo shoqëri e ka transferuar veprimtarinë ekonomike si dhe aktivitetet dhe detyrimet e saj në tërësi. Nga data 01.01.2023, kjo shoqëri nuk ka më të drejtë të zhvillojë aktivitetin për të cilin ajo është themeluar.

Për sa konstatohet më sipër, shoqëria e ka përmbushur qëllimin e krijimit dhe nuk ka më arsye të villojë ekzistencën e saj dhe duhet të priset dhe të cregjistrohet nga regjistri tregtar QKB.

**Pasi diskutoi gjerësisht mbi rendin e ditës, Asambleja vendosi:**

- (1) Përfundimin e aktivitetit të shoqërisë dhe prishjen e saj
- (2) Shoqëria shpall hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese;
- (3) Emërimin e Z. Ferit Mazrreku si likuidator të shoqërisë.
- (4) Likuidatori është i autorizuar të përgatisë Raportin Përfundimtar të likuidimit të shoqërisë. Ai është gjithashtu i autorizuar të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për likuidimin e shoqërisë si dhe të kërkojë, paraqesë çdo dokument të nevojshëm pranë autoriteteve private dhe publike në lidhje me likuidimin e shoqërisë.

Pasi u sigurua se nuk ka më çështje për diskutim, mbledhja mbyllet dhe vendimi nënshkruhet në 3 kopje identike si vijon.

ASAMBLEJA E AKSIONARËVE

KRYETAR

Lima MORINA

